

Profesori maqedonas studion kërpudhat e Shqipërisë



Shkup, 25 qershor- Ekipi i udhëhequr nga Profesor Mitko Karadelev nga Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore në Shkup tashmë është duke punuar një kohë në projektin "Kërpudhat e Shqipërisë: Verifikimi (përcaktimi) i listës së kërpudhave dhe Listës së kuqe prelinare (parapake) si dhe propozimi i regjioneve të rëndësishme të kërpudhave në Shqipëri" (1 prill 2013 - 30 shtator 2014), mbështetur nga Fondacioni "Raforid të Anglisë".

Ekipi mbështetet në përvojën e tij në lidhje me Listën e Kuqe, të fituar në një projekt të ngjashëm për ruajtjen e kërpudhave e zbatuar në Maqedoni. Deri më tani, kërpudhat e Shqipërisë ishin të

studiuar shumë pak dhe kishte informacione zyrtare mjaft të rralla rreth tyre. Vendi nuk disponon me përshkrim të kërpudhave as me listë të kuqe.

Mungon Legjislacioni për mbrojtjen e kërpudhave edhe pse eksportohen sasi të mëdha të kërpudhave. Duke iu falënderuar shumëllojshmërisë së klimës, tipeve vegjetative dhe substrateve, pritej një diversitet i lartë i kërpudhave, kurse me projektin u konfirmuan këto pritje.

Janë marrë të dhëna për rreth 600 lloje të kërpudhave dhe më pas u formua një bazë e të dhënave për të gjitha llojet e kërpudhave të identifikuar në Shqipëri, që është në dispozicion online (<http://macfunji.webs.com/fungjialbanici.htm>).

Projekti përfshin edhe ngritjen e vetëdijes publike përmes ligjëratave përpara banorëve vendor si dhe zyrtarëve relevante shqiptare, mbi këtë çështje dhe shpërndarjen e materialeve promovuese.

Studimet e shumta në terren janë kryer në më shumë se 30 vende në pjesë të ndryshme të vendit, kryesisht në parqet nacionale: Valbona, Hotovës, Prespa, Llogara, Dajti, Shebenik-Jabllanicë, Korab-Koritnik dhe Tomor.

Lista e parë parapake e kërpudhave, përgatitur në përputhje me kriteret e IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës-UNRN), është gati dhe u paraqit në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare e Ekosistemeve në Tiranë ICE-2014 (23-26 Maj-2014).

Do të propozohen edhe fusha të rëndësishme të kërpudhave (FRK), në varësi nga prania e specieve të rralla dhe të rrezikuara, pasuria dhe rëndësia mikologjike e habitateve.

Lista do të jetë bazë për përpilimin e një liste të Kuqe zyrtare të kërpudhave dhe përgatitjen e legjislacionit për mbrojtjen e kërpudhave. Aktivitetet e këtij projekti mund të futen më tej në Strategjinë Kombëtare shqiptare dhe PlanitAksionar për Biodiversitetin.

Ekzemplar reprezentues të kërpudhave do t'i dhurohen Muzeut Shkencor-Natyromë Shqipëri apo ndonjë institucioni të interesuar me qëllim të krijimit të një Koleksioni Kombëtar të Kërpudhave të Shqipërisë.

© ZHURNAL.mk

Publikuar më 25.06.2014 në 10:56 nga R.ZH.

2,528 herë i lexuar



Të gjitha të drejtat e përmbajtjes në këtë portal janë të rezervuara.

Ndalohet ribotimi i përmbajtjes (lajmeve dhe të gjitha shkrimeve të tjera) pa lejen me shkrim të portalit « Zhurnal ». Çdo përdorues publik i përmbajtjes sonë pa autorizimin e posaçëm nga « Zhurnal » rrezikon të ballafaqohet me ligjin.

568 online

2010 - 2015 © ZHURNAL - Agjenci e lajmeve



"Dnevnik": BDI-në do të themelohet Parlament shqiptar në Maqedoni?! BDI për Zhurnal: Nuk është



Menduh Jashari zgjidhet kryetar i PPD-së dega në Komunë të Likovës



Diaspora kritikon partitë shqiptare nga viti 2002 që iu "gjunjzuan" Gruevskit dhe Cërvenkovskit



U arrestuan tri persona nga aksioni i sotëm policor në Lagjen e trimave



Thaçi-Feith: Marrëveshja e Përzihos të implementohet



Maleski: Ambasadorët, Gruevskit po i tregojnë frerët



RDK uron Kosovën për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit me Bashkimin



Spitali i qytetit: Mos i nxini mjekët, pak prej tyre janë të na nërnieishëm

European



Selmani: Për cilin popull Gruevski e ka fjalën, pasi që vetëm 26 % kanë votuar për të?



Të Bashkuar për Maqedoninë në një takim pune me Zaevin